

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

GJUHA JONË

1-2/2002

Çmimi 200 lekë

Xhani BELUSHO (Gianni BELLUSCIO)
Universiteti i Kalabrisë

DREJTIME TË POLITIKËS GJUHËSORE TË MONARKISË DHE TË REPUBLIKËS NË DOKUMENTE ZYRTARE TË SHTETIT SHQIPTAR (KARTËMONEDHAT DHE PULLAT POSTARE)

Një provë të pakundërshtueshme të jetësimit praktik të politikës gjuhësore në Shqipëri, që përpara se ajo të përvijohet nga komisionet gjuhësore ose të teorizohet nga studiuesit, na e japin dokumentet zyrtare të shtetit me qarkullim të gjerë, si kartëmonedhat, pullat e postës dhe aktet parlamentare, politike, kushtetuese etj. Është e qartë se mjeti më përfaqësues dhe me kontaktin më të dendur me popullsinë janë kartëmonedhat dhe vlerat filatelike, të cilat, përveç kryerjes së funksioneve të paracaktuara, përfaqësojnë edhe aspekte të tjera të rendit politik të vendosur. Për sa i përket monedhës (në të dyja format e saj, metalike dhe prej letre) me të drejtë G. Toniolo në parathënien e vëllimit të autorit Carlo M. Cipolla, *Le avventure della lira*¹ ("Aventurat e lirës", 1975) thekson se "monedha përmbledh në vetvete, si asnjë tregues tjetër sintetik, jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të një populli". Edhe në rastin e Shqipërisë, analiza e monedhave dhe e kartëmonedhave ofron një pamje të qartë të ngjarjeve historike, politike dhe kulturore të shtetit; në fakt, duke vëzhguar me kujdes, mbi bazën e dokumenteve që kemi në dispozicion, kartëmonedhat, monedhat dhe pullat e postës, është e mundur të ndiqet ndërmjet të tjerash edhe përdorimi i gjuhës shqipe në to dhe po ashtu edhe se si janë gërshetuar ngjarjet

¹ Carlo M. Cipolla, *Le avventure della lira*. Il Mulino, Bologna 2001 (prima edizione 1975).

politike me zgjedhjet gjuhësore, në mënyrë të veçantë në çastin vendimtar të kalimit nga monarkia përkatësisht administrata e pushtimit në republikën popullore. Kartëmonedhat ashtu edhe pullat e postës tregojnë se kthesa ka qenë rrënjësore dhe e menjëhershme që në çastet e para të jetës së rendit të ri politik.

Dokumentet

Dokumentet e analizuara këtu kanë të bëjnë me disa seri letrash me vlerë ligjore që shkojnë që nga viti 1913 deri më 1997, riprodhimet e të cilave janë botuar në site interneti të specializuara për numizmatikën, si edhe në një numër të kufizuar riprodhimesh të pullave shqiptare të hedhura në qarkullim gjatë viteve 1943-1946¹. Seritë nuk janë të plota, por mjaft domethënëse; nuk kemi gjetur botime të veçanta për historinë dhe zhvillimin e përdorimit të kartëmonedhave dhe të pullave të postës në Shqipëri pas shpalljes së Pavarësisë më 1912; do të ishte tejet e dobishme të hetohej në Bankën e Shqipërisë për ekzistencën e dokumenteve zyrtare që nga viti 1912 e deri më sot.

Paraqitja e dokumenteve

Kartëmonedhat

Kartëmonedhat e para të shtetit shqiptar shfaqen më 1926. Përpara këtij viti kemi mundur të analizojmë, duke filluar nga viti 1913, vetëm dokumente letre të hedhura në qarkullim nga "institute bankare" private të llojit bashkiak ose krahinor; po japim këtu një paraqitje të shpejtë, sipas viteve, të dokumenteve të analizuara, së bashku me transkriptimin e mbishkrimeve:

1913. Dokumenti i parë me vlerë monetare që kemi gjetur, është i këtij viti, nuk kuptohet mirë cila ka qenë vlera e tij, as nëse ishte i kufizuar vetëm në përdorimin hekurudhor², vlerat janë në *gros* dhe *para*, veç kësaj gjejmë të shkruar *Esat Pasha, Shqiperia* (pra me prejardhje jugore) dhe diçiturën "*për udhë shemendefer*", tepër i veçantë përdorimi i fjalës frëngjisht në vend të *hekurudhë*.

1920. Një seri vlerash në kartëmonedhë hidhet në qarkullim nga shtypshkronja private Perlimtarja e Shkodrës, me vlera 5, 10 e 20 *qindtar* për t'i dalë përpara mungesës së monedhave me vlerë të vogël (këto të kujtojnë miniçeqet që qarkullonin në Itali në vitet '70 të shekullit të kaluar); në faqen e përparme shkruhet: "*Sigurim Arke / i Perlimtares së Shkodrës / përmbi /5 Qindtar /*

¹ Falenderoj prof. John Trumper, i cili më vuri në dispozicion koleksionin e tij të pullave shqiptare.
² Në vitin 1913 në territorin e shtetit shqiptar nuk kishte asnjë km hekurudhë (*Shën. i përkth.*)

Perlimtarja e Shkodrës pëngohet per ket / detyrë me të gjith gjâne e tûndshme e të / pa- tûndshme të veten Shkodër 30-1-1920 / Nenkryetari, Kryetari, Këshilltari”, ndërsa në anën e prapme: Sigurim Arke i perlimtares së Shkodrës / Përmbi 5 Qindtar / per me lehtësue ngushticen e të holla / ve të vogla Perlimtaria e Shkodrës po / shtypë shumë e 5000 pesedhetemi Fr. serm / ky sigurim arke âsht pa interesë (faiz) e merr / et në pagesë prej Perlimtares së Shkodrës deri / me 30 VI-1920 e mlidee i prep prej arkes së perlim / tares tue i kthye vjeftjen serm me i 30-VI-1920 / Të perbamit i ktyne sigurimevet arke / ka me kën i ndeshkuëm mbas ligjës”.

1921. Gjejmë në qarkullim njësitë monetare *skënder* me vlerë ½ Gjysmë dhe *1 Një*, të shtypura nga Katundari’ e Korçës, veç emetuesit në faqen e përparme shihet një riprodhim i përafërt i profilit të Skënderbeut me mbishkrimin Gjergj Kastrioti dhe diçitura “*Skënder Gjysmë* (ose *Skënder Një*), *Kryekatundari / Kasieri / Me të çfaqur paguhet*”, së fundi, në anën e poshtme emri i tipografisë “*Gdh. Shtyp. Dhori Koti*”; një seri tjetër ka mbishkrimin *Katundaria e Korçës*, Skënderbeun në kalë me flamurin shqiptar në faqen e përparme, ndërsa në faqen e prapme një bujk me parmendë dhe ka.

1924. Një kartëmonedhë e bashkisë së Vlorës që ka në faqen e përparme një bust mashkullor dhe diçiturën: *Bashkia e Vlorës / Seria C / Frank Një Kart / Kryetar’ i Bashkis / Arkëtari*, ndërsa në faqen e pasme: *Sigurohet me pasunit’ e pa tundeshme / të Bashkisë / Paguhet me t’u paraqitur / Frank I Kart / Vendim’ i Këshillit / të Bashkisë / më 11 Maj 1924 / Falsifikonjësit dënohen pas ligjit.*

1925. Një seri e hedhur në qarkullim nga bashkia e Elbasanit në franga argjendi prej 0,10, 0,20 e 0,40, me diçiturën: *Bashkia e Elbasanit / 0,40 Fr. argj. 0,40 / Paguhet me t’u paraqit / Arktari / Kryetari* në faqen e përparme dhe vetëm vlerën, një shqiptarë dykrerëshe dhe numrin e serisë në faqen e prapme.

1926. Hidhen në qarkullim kartëmonedhat e para të Bankës Kombëtare të Shqipnis, me vlerë në Franka Ari ‘franchi oro’, që kanë profilin e Zogut mbi kartëmonedhën prej 100 Fr. ar dhe fytyra fëmijësh shqiptarë, ndërsa në faqen e pasme kanë pamje nga peizazhet shqiptare. Diçiturat janë italisht, së bashku me përkthimin shqip të formulave tipike të kartëmonedhave italiane: *Banka Kombëtare e Shqipnis Banca Nazionale d’Albania / Nji qind Franka Ari Cento Franchi Oro / Të pagueshëme në të pame pruësit Pagabili a vista al portatore / Kryetari Il Presidente / Këshilltari sekretar Il Consigliere*

segretario / Ligji dënon fabrikatorët dhe shpërndaesit e biletave të fallsifikueme La legge punisce i fabbricatori e gli spacciatori di biglietti falsi.

1939. Zhduket fytyra e Zogut dhe në faqen e përparme të kartëmonedhës prej 100 frangash ar vendoset shqiptarja dykrerëshe me një kurorë mbi krye, ndërsa në faqen e prapme kemi përsëri një pamje nga peizazhi shqiptar. Në të njëjtin vit shfaqen kartëmonedha të tjera të llojeve të ndryshme me vlerë 5, 20 dhe 100 Franga Ari (të vihet re grupi -ng- në vend të -nk-), dhe në kartëmonedhën prej 20 Fr. ar shfaqen simbole romake, si ujkonja e Kapitolit dhe shtatorja e Minervës. Diçiturat mbeten të njëjta me të mëparshmet, ndërsa në kartëmonedhën prej 20 Fr. ar mund të lexohet edhe ‘*Officina della Banca d’Italia Roma*’.

1944. Kartëmonedhat e hedhura në qarkullim në këtë vit kanë një kompozim grafik të karakterizuar fort prej stilit liktor, qoftë në simbolet e administratës fashiste të Shqipërisë, qoftë në ikonografinë e tyre. Shqiptarja dykrerëshe paraqitet me krahë më të ngritur, për ta afruar me tipologjinë e shqiptarjes romake; mbi kartëmonedhën me vlerë 100 Lek gjejmë tetragramën e familjes Savoia FERT dhe në filigranë profilin e Viktor Emanuelit III ‘perandor i Etiopisë dhe i Shqipërisë’. Monedha e re për herë të parë quhet Lek në kartëmonedhat me vlerë 2, 5, 10, 100 lek. Diçiturat tipike janë të njëjta me të mëparshmet: *5 lek / Ligji dënon fabrikatorët dhe shpërndaesit e biletave të fallsifikueme / La legge punisce i fabbricatori e gli spacciatori di biglietti falsi / Banka Kombëtare e Shqipnis / Banca Nazionale d’Albania / Pagabili a vista al portatore / Kryetari Il Presidente / Këshilltari delegat Il Consigliere delegato / Officina della Banca d’Italia – Roma / 5 Lek / Me të pamë të pagueshme prusit.*

1945. Mbi kartëmonedhat e mëparshme, por edhe mbi kartëmonedhat e tjera (për shembull edhe mbi një kartëmonedhë 20 fr. ar të vitit 1926) vendoset një vulë katërkëndëshe me diçiturën *Banka e Shtetit Shqiptar* me shqiptarjen dykrerëshe në qendër, që për herë të parë ka yllin pesëcepësh mbi krye. Në të njëjtin vit rendi i ri politik hedh në qarkullim kartëmonedhat e reja me vlerë në franga, prej 5, 20, 100 e 500 Fr. Shfaqen menjëherë diçiturat në toskërisht: *Banka e Shtetit Shqiptar / Pesë franga / I paguhet prurësit me të parë / Tiranë, 1 maj 1945 / Banka e Shtetit Shqiptar / Pesë franga / Ligja dënon ata që fabrikojnë dhe ndajnë bileta të falsifikuara.* Në të gjitha kartëmonedhat shfaqet profili i Skënderbeut, ndërsa në faqen e pasme shqiptarja dykrerëshe me yllin me pesë cepa mbi krye. Zhduket përfundimisht italishtja si

dhe format gegërisht të numërorëve “një qint, njëzet, pesë qint”, ashtu edhe të fjalëve të tjera në formulat kanonike të kartëmonedhave. Hedhja në qarkullim bëhet jo rastësisht më 1 Maj.

1947. Rishfaqet për t’u afirmuar përfundimisht leku. Kartëmonedhat mbajnë mbishkrimet *Banka e Shtetit Shqiptar / Dhjetë lekë / I paguhen prurësit me të parë / 1947 Banka e Shtetit Shqiptar / Dhjetë lekë / Ligja dënon ata që fabrikojnë dhe ndajnë bileta të falsifikuara.*

1949. Në serinë e re (e cila hidhet në qarkullim më 1957) shfaqet për herë të parë ikonografia e stilit socialist në nderim të luftës çlirimtare, me buste dhe fytyra partizanësh dhe paraqitjen e punës për ndërtimin e shtetit të ri socialist shqiptar (minator, korrëse, fshatarë në të korra dhe të vjela). *Banka e Shtetit Shqiptar / Dhjetë lekë / I paguhen prurësit me të parë / 1949 Banka e Shtetit Shqiptar / Dhjetë lekë / Ligja dënon ata që fabrikojnë dhe ndajnë bileta të falsifikuara.*

1964. Shfaqet seria e re e kartëmonedhave (që do të hidhen në qarkullim edhe më 1976) dhe do të shoqërojnë Republikën Popullore pothuaj deri në rënien e saj. Shteti tashmë është konsoliduar dhe kartëmonedhat janë paraqitja ikonografike e përparimeve të arritura në fushat e ndryshme të jetës shoqërore dhe ekonomike të vendit, janë një himn për industrinë e popullit shqiptar dhe për ndërtimin e shtetit socialist. Kartëmonedhat me vlerë 1, 3, 5, 10, 25, 50 e 100 lekë kanë: mbi anën e përparme *Banka e Shtetit Shqiptar / Një lek / I paguhen prurësit me të parë*; dhe mbi anën e prapme *Banka e Shtetit Shqiptar / Ligja dënon ata që fabrikojnë / dhe ndajnë bileta të falsifikuara.* Për t’u përmendur edhe fakti që me këtë seri të re u krye edhe ndërrimi i njësisë dhe i vlerës formale të lekut. Kështu 1000 lekë u shndërruan në 100 lekë, gjë që solli ngatërrimin e lekëve të vjetër me lekët e rinj, zakon që është i gjallë edhe sot e kësaj dite: pra çmimet shkruhen në një mënyrë dhe lexohen në një mënyrë tjetër (kështu edhe në disa vende të tjera).

1991. Hidhet në qarkullim seria e fundit e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, në të cilën ruhen simbolet e shtetit socialist dhe diçitura “Banka e Shtetit Shqiptar”, por zhduken për herë të parë të gjitha mbishkrimet e tjera kanonike që kishin shoqëruar deri atëherë kartëmonedhat shqiptare. Kartëmonedha me vlerë 100 Lekë ka shumë ngjashmëri me kartëmonedhën përkatëse të hedhur në qarkullim më 1964, si për sa i përket ikonografisë ashtu edhe për ngjyrat, por vlera jepet në *lek valutë.*

1992. Seria e parë e Republikës së Shqipërisë ndryshon rrënjësisht

ikonografinë e kartëmonedhave, duke i përshtatur ato me sistemin e ri me anë të përkujtimit të figurave të shquara dhe vendeve të lidhura me historinë e Shqipërisë. Ruhet zgjedhja e mëparshme për të mënjanuar mbishkrimet që kanë të bëjnë me falsifikimin dhe pagimin me të parë.

Pullat e postës

Siç u tha më lart për kartëmonedhat dhe monedhat, edhe pullat mund të japin dëshmi për gjuhën zyrtare që përdoret në një shtet. Historia e filatelistë shqiptare zë fill në vitin 1913, vit kur shfaqet mbishtëypja e parë mbi pullat turke të vitit 1908: shqiponja dykrerëshe me poshtëshënimin SHQIPËNIA. Pullat kanë “tekste” më të shkurtra se kartëmonedhat, nuk paraqesin ndonjë varietet gjuhësor më të madh. Veç kësaj atyre u duhen shtuar edhe shkrimet e vulave dhe të mbishtëypjeve.

Duke u nisur nga shumëllojshmëria e formave shqipe për emrin *Shqipëri* të vërehet në pasqyrën e mëposhtme se në pullat e postës ajo ka qenë shumë më e ndryshme dhe përdorimi i saj shumë më anarkik, por duhet mbajtur parasysh edhe fakti që shpesh këto janë seri (dhe mbishtëypje) filatelike të kufizuara në zona me ndikim të ndryshëm gjuhësor, si në rastin e Shkodrës 1913 e 1919, të Korçës 1914; të Mirditës 1917; duhet vënë në dukje gjithashtu, si rast emblemantik, fakti domethënës i emërtimit të ndryshëm të Shqipërisë nga ana e shtetit socialist në kundërshtim me vazhdimësinë gjuhësore të llojit gegë në emisione (nuk dimë nëse me vlerë të vërtetë apo thjesht si propagandë) të qeverisë në mërgim në një pullë të vitit 1964.

1913 mbishtëypje në pullat turke të vitit 1908	SHQIPËNIA
1913	TË SHQIPËNIES
1919	E SHQYPNIS
1920	SHQIPËNIE
1922	SHQYPARE
1937	SHQIPNI
1944	E SHQIPËRISË
1947	SHQIPERIJA
1950	SHQIPËRIA
1964 Qeveria në mërgim	SHQIPNIJA

Pullat pasqyrojnë në këtë mënyrë njaft hollësisht ndërrimet e qeverisjes dhe të sistemit politik, dhe me këtë edhe ikonografinë zyrtare dhe përdorimin e gjuhës “kombëtare”.

1913 Administrim autonom (*Qeverria e Shqipnis Mesme, Albanie Centrale, Tarabosh 1913; Postat e Qeverries (anche Qeveries) së Përkoheshme të Shqipëniës; Shqipënia e lirë, Skanderbergu Mbreti i Shqipëtarëve*).

1914-1921 Principatë (me rastin e hyrjes së Princit Vid në Durrës gjejmë të mbishtypur *7 Mars Rroftë Mbreti*).

1922-1928 Republikë (*Posta Shqyptare, Republika Shqiptare Kallnduer 1925; Mbledhje Kushtetuese Tiranë Kallnuer 1924 (mbishtypur); Triumf'i legalitetit 24 Dhetuer 1924; Posta aerore Shqyptare, 10 qind 1928; Republika Shqiptare (mbivendosje); (vëmë në dukje ndryshimin në të shkruar Kallnuer-kallnduer dhe variacionin e neologjizmit që shfaqet më 1925 si *posta aerore* e më 1928 si *posta ajrore* që do të jetë forma përfundimtare e kësaj fjale).*

1928-1939 Mbretëri (*Republika Shqiptare, (A. Zogu president); 1928 mbishtypur Mbretëria Shqiptare; Mbretëria Shqyptare, Posta Ajrore; Rroft Mbreti 8.X.1929 (mbisht.); Shqipni (1937 e 38).*

1939-1944 Administrim italian (*Mbledhja kushtetuese 12-VI-1939 XVII; Mbretëria Shqiptare 1940; Postat Expres (sic!)*).

1943-1944 Administrim gjerman (vetëm mbishtypja *14 shtator 1943* në pullat ekzistuese).

1944-1946 Republikë demokratike (*QEVERIA DEMOKRAT. E SHQIPERISE 22-X-1944 (mbisht.); Shqipnija, Ndihmë për të mjeruarët nga lufta; 1943-1945 U.N.ÇL. SHQ. 10 Korrik Fr. Shq. 2 (mbishtypje në pullat e vitit 1930, me yll të kuq); QEVERIA DEMOK. E SHQIPERISE, Java e K.K. Shqiptar 4-11 Maj 1945 Fr. SHq. 2+1 (mbisht.) Qeveria Demokratike e Shqipnis.*

1946-1991 Republikë popullore (1946-1976), Republikë popullore socialiste (1976-1991) (*Republika Popullore e Shqipërisë, Federata Demokratike Ndërkombëtare e Grave 1946, etj.*)

1991- Republikë (*Posta Shqiptare mbisht. e më pas si diçiturë zyrtare*).

Ndryshueshmëria gjuhësore e vënë re në kartëmonedhat shfaqet po ashtu edhe në pullat e postës në periudhën e shkurtër të kalimit nga regjimi fashist në republikën demokratike. Në këtë çast historik, nga njëra anë, gjejmë pullat e mbishtypura të administratës gjermane, të cilat nuk na japin asnjë tregues të dobishëm për qëllimin tonë, të hedhura në qarkullim një herë të vetme me vazhdimin

e formës gege *Shqipnija* në një pullë të vitit 1944 për të ndihmuar refugjatët e luftës dhe, nga ana tjetër, shfaqet i mbishtypur modeli “i ri” gjuhësor mbi bazën e toskërishtes, i paraqitur prej atij që do të bëhet regjimi i ri politik shqiptar, edhe pse në të vihet re një ndryshueshmëri e pakët ose lëshime ndaj gegërishtes, si në rastin e fjalës *Lojnat* në pulla me subjekt sportiv të hedhura në qarkullim më 1946 dhe 1964. Por më 1975, pak kohë pas Kongresit të Drejtshkrimit që u mbajt më 1972, e njëjta fjalë shfaqet në përputhje me formën toske me *-r-* në vend të *-n-*: “*Në prak të lojrave olimpikë*”. Megjithatë, në *Fjalorin drejtshkrimor* të vitit 1976 jepet edhe forma gege krahas formës kryesore të llojit toskë.

Zgjedhjet gjuhësore

Gjatë ndryshimeve të regjimit politik dhe të organizimit shtetëror zëvendësimi i mbishkrimeve politiko-administrative, në radhë të parë në simbolet qarkulluese, i bërë për të “reklamuar” dhe vendosur rendin e ri dhe simbologjinë e re të pushtetit, shfaqet si veprim i menjëhershëm. Kështu ndodhi me ardhjen në fuqi të Zogut, pastaj me pushtimin fashist, u përsërit kjo gjë me ardhjen e pushtetit komunist e, së fundi, me vendosjen e shtetit demokratik. Një ndryshueshmëri jo dytësore ka të bëjë edhe me përdorimin e gjuhës në këto ‘dokumente’ zyrtare, edhe pse në një mjedis tepër të kufizuar, duke mbajtur parasysht përdorimin e kufizuar të gjuhës së shkruar në to.

Megjithatë, pikërisht për shkak se tekstet e tyre janë tejet të shkurtra, ato fitojnë një ngarkesë të fortë informacioni gjuhësor, në saje të faktit që këtu gjuha ka karakter të theksuar zyrtar dhe komunikues. Nga ana tjetër, duhet thënë se kush përdor kartëmonedha, monedha dhe pulla poste, pas kontaktit të parë vështirë se kthehet të lexojë dhe të vëzhgojë ç’është shkruar ose paraqitur mbi to. Por një analizë metodike dhe krahasuese e materialeve bën të mundur të vihen në dukje e të perceptohen variacionet diakronike në përdorimin e formulave dhe të fjalëve të veçanta, të formës së tyre grafike etj., duke na nxitur të kapim valencat e mundshme gjuhësore dhe politike.

Nga viti 1926 deri më 1944 të gjitha mbishkrimet e kartëmonedhave ishin në gegërishten qendrore, edhe në përputhje me zgjedhjen e Komisionit Letraro të Shkodrës. Megjithatë, në disa raste vërehet një lloj ndryshueshmërie, si p.sh.: *Franka ari* që bëhet *Franga ari* që nga viti 1939; realizimi i ndryshëm i ndonjë grupi zanor: *pruësit* që përdorej deri më 1944 më pas u ndryshua në *prusit* me reduktimin e grupit zanor *uë*. Kartëmonedhat kanë pasur që në fillim formën e diçiturave italiane me sa duket për shkak të faktit që ato shpesh shtypeshin në

shtypshkronjat italiane, siç duket qartë në kartëmonedhën e zhvlerësuar të vitit 1925, të shypur në Off. carte valori Richter & C. Napoli.

Kthesa më interesante për ne ndodhi në vitin 1944, kur në seri të ndryshme kartëmonedhash u shfaq e mbishtypur në ngjyrë të zezë shqiponja me dy krerë me yllin pesëcepësh mbi krye dhe u ndryshua emërtimi i bankës së shtetit të ri shqiptar, në Banka e Shtetit Shqiptar në vend të emërtimit Banka Kombetare e Shqipnis, i përdorur që në kartëmonedhat e para, fakt i cili në vetvete është i mjaftueshëm për të parashikuar ndryshimet e mëvonshme që nuk mund të shtyeshin më: ndryshimi i vlerave në qarkullim, shndërrimi ikonografik pas zëvendësimit të regjimit fashist me atë të republikës socialiste, vendosja e valutës së re : zëvendësimi i lekut të përdorur gjatë regjimit fashist me valutën e mëparshme në franga ari, për t'u rikthyer te leku më 1947 dhe së fundi, "provat" e kodit të ri zyrtar gjuhësor mbi bazën e toskërishtes, si edhe, për herë të parë në historinë monetare shqiptare, përdorimi vetëm i gjuhës shqipe, duke ndërprerë kështu traditën e dygjuhësisë italisht-shqip të viteve 1926-1944, një shenjë e fortë domethënëse për autonominë e ardhshme politike dhe ekonomike të shtetit të ri.

Duke u mbështetur në formulat kanonike të shtypura në kartëmonedha dhe në formën e shkruar të numërorëve, po paraqesim pasqyrën sinoptike të mëposhtme:

	valuta	Banka	Ligji dënon...	Paguhen me të parë...	Numërorë
1926	Franka Ari	Banka Kombëtare e Shqipnis	Ligji dënon fabrikatorët dhe shpërndaesit e biletave të falsifikueme	Të pagueshme në të pame pruësit	Nji qind Pesë Njizet
1939	Franga Ari	Banka Kombëtare e Shqipnis	Ligji dënon fabrikatorët dhe shpërndaesit e biletave të falsifikueme	Të pagueshme në të pame pruësit	Njizet Pesë
1944	lek	Banka Kombëtare e Shqipnis	Ligji dënon fabrikatorët dhe shpërndaesit e biletave të falsifikueme	Me të pamë të pagueshme prusit	Njiqind
1945	franga ari	Banka e Shtetit Shqiptar	Ligja dënon ata që fabrikojnë dhe ndajnë bileta të falsifikuara	I paguhen prurësit me të parë	Pesë Njëzet Njëqint Pesë qint

¹ Kartëmonedha e parë e vitit 1925 (me sa duket një ekzemplar që nuk hyri kurrë në qarkullim) në të vërtetë kishte si vlerën në lekë ashtu edhe atë në franga ar (5 lek = 1frangë ar), më pas valuta në lek u rishfaq vetëm më 1944 e më pas, përfundimisht, më 1947.

1947	lek	Banka e Shtetit Shqiptar	Ligja dënon ata që fabrikojnë dhe ndajnë bileta të falsifikuara	I paguhen prurësit me të parë	Pesëdhjetë Një qint
1949	lek	Banka e Shtetit Shqiptar	Ligja dënon ata që fabrikojnë dhe ndajnë bileta të falsifikuara	I paguhen prurësit me të parë	Dhjetë Pesëdhjetë Njëqint
1957	lek	Banka e Shtetit Shqiptar	Ligja dënon ata që fabrikojnë dhe ndajnë bileta të falsifikuara	I paguhen prurësit me të parë	Njëqint Dhjetë Pesë qint një mijë Pesëdhjetë
1964-1976	lek	Banka e Shtetit Shqiptar	Ligja dënon ata që fabrikojnë dhe ndajnë bileta të falsifikuara	I paguhen prurësit me të parë	Dhjetë Pesë Një Tre Pesëdhjetë Një Qint
1991	lek valutë	Banka e Shtetit Shqiptar Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë			Një qind Peseqinde leke
1992-1996	lek	Banka e Shqipërisë			Njëmijë Njëqind Dyqind Pesëmijë Pesëqind

Përfundim

Përdorimi i kodit gjuhësor është në një farë mënyre përçues dhe shprehje e realitetit politik, ekonomik dhe shoqëror të shtetit; kartëmonedhat nuk kanë vetëm vultat dhe ikonografitë e pushtetit të vendosur, por shprehin edhe drejtimet e politikës gjuhësore. Kjo kishte ndodhur në mënyrë më të kufizuar gjatë pushtimit fashist, kryesisht për sa i përket ikonografisë shtetërore dhe për ndonjë ndryshim në formulën “pagabili a vista... (paguhen me të parë...)”, por bëhet e qartë, mbi të gjitha gjatë kalimit nga monarkia në republikën socialiste, që zgjedhja dhe vendosja e një kodi të ri gjuhësor të mbështetur për herë të parë në variantin toskë duket se dëshiron të shoqërojë thyerjen përfundimtare dhe të pakthyeshme me të kaluarën, për të shënuar një fazë krejt të re dhe origjinale të historisë dhe jetës politike e shoqërore të Shqipërisë së re. Republika e pavarur duket në zgjedhjen për të përdorur për herë të parë vetëm gjuhën shqipe; një shtet i ri i lindur nga një revolucion i ri, një krijesë e re që ka nevojë edhe për një virgjëri gjuhësore, shenjë e pakundërshtueshme dhe vendimtare e politikës gjuhësore që do të normohet dhe do të organizohet në vitet e mëvonshme. Diçka e ngjashme do të përsëritej përpara rënies së regjimit, kur shteti socialist i lëkundur e në agoni me sa duket e pa të nevojshme të ripohonte në kartëmonedha ekzistencën e vet, duke shënuar për herë të parë “Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë” dhe duke e shndërruar lekun në lek valutë (por ky është një aspekt ekonomik, tregues gjithsesi i një gjendjeje të veçantë) dhe, së fundi, me shndërrimin e fundit demokratik të Shqipërisë, kur pranohet vetëm një emërtim i ri i Bankës së Shtetit dhe ikonografia e përshtatshme me vijën e re, në pritje të euros. Në këtë pikë mund të pohojmë me siguri që politika gjuhësore e shtetit të ri shqiptar hedh hapat e parë në drejtim të bazës toskë të gjuhës kombëtare që në çastin e rënies së regjimit fashist dhe të çlirimit të vendit. Dokumentet e shqyrtuara na japin elemente të mjaftueshme për të pohuar këtë fakt. Do të ishte me interes të veçantë që të njiheshin aktet zyrtare sipas të cilave u kryen ndryshimet gjuhësore të përshkruara më sipër.